

**PLANI PËR MENAXHIM ME MBETURINAT**

**2020-2025**

**KOMUNA E TEARCËS**

**Janar 2020**

## PËRMBAJTJA

Hyrje.....	4
I. PLANI PËR MENAXHIM ME MBETURINAT NË KOMUNËN E TEARCËS ( 2020- 2025).....	5
1.Përshkrimi dhe vlerësimi i gjendjes faktike në lidhje me menaxhimin me mbeturina.....	5
1.1 Gjendja me selektimin dhe riciklimin e mbeturinave komunale.....	8
1.2 Gjendja me mbeturinat e biodegraduara.....	9
1.3 Gjendja me mbeturinat industriale.....	10
1.4 Gjendja me mbeturinat e rrezikshme.....	10
1.5 Gjendja me situatën financiare gjatë menaxhimit me mbeturinat.....	11
2.Parashikimi i gjendjes në të ardhmen në lidhje me menaxhimin e mbeturinave në komunë.....	11
2.1 Gjenerimi i mbeturinave.....	11
2.2 Grumbullimi, transportimi dhe deponimi i mbeturinave.....	11
3. Drejtimet dhe qëllimet në lidhje me menaxhimin me mbeturinat.....	11
4.Masat stimulative për realizimin e aktiviteteve për shmangien dhe zvogëlimin e sasisë së mbeturinave të krijuara, si dhe shfrytëzimi i së njëjtës, riciklimi dhe shfrytëzimi i mbeturinave si burim i energjisë.....	12
5. Mënyra për mënjanimin e mbeturinave e cila nuk mund të shmanget dhe të përpunohet.....	13
6. Përcaktimi i llojit dhe sasisë së mbeturinës sipas të cilave përcaktohet obligimi i personave juridikë dhe fizikë që të përgaditin programe për menaxhim me mbeturinat.....	14
7. Realizimi i sistemit për monitorim gjatë menaxhimit me mbeturina.....	14
8. Masat konkrete dhe aktivitetet për zvogëlimin e përbërjeve biodegraduese në mbeturinë e dedikuara për mënjanim dhe programet kohore dhe vëllimi i realizimit të tyre.....	15
8.1 Baza për futjen në kompostim të mbeturinave biodegraduara.....	16
9. Përcaktimi i nevojave të komunës për ndërtimin e objekteve dhe instalimeve për përpunimin e mbeturinave.....	16
10.Llokacionet dhe instalimet për mënjanimi e mbeturinave.....	18
11. Të dhënat për rrjetin e integruar nacional për mënjanimin e mbeturinave dhe instalimet për përpunimin e mbeturinave.....	18
12. Kushtet teknike dhe të tjera të cilët duhet të plotësohen gjatë menaxhimit me mbeturina.....	18

13. Masat për sanimin e deponive të egra dhe rajoneve të ndotura.....	19
14. Aktivitetet të cilat ndërmerren nga ana e njësisë së vetqeverisjes lokale në lidhje me menaxhimin me mbeturina.....	19
15. Masat për edukimin dhe për ngritjen e vetëdijes publike për menaxhim me mbeturina.....	21
16. Vlerësimi i harxhimeve për operacionet e përpunimit dhe menjanimit të mbeturinave.....	22
17. Instrumentet financiare për zbatimin e planit për menaxhim me mbeturina.....	23

## Hyrje

Planifikimi është mjete themelor për vendosjen e sistemit afatgjat për menaxhim me mbeturina. Kapitulli II i ligjit për mbeturina ( Gazeta zyrtare nr.68/2004,71/2004,107/2007,102/2008, 143/2008, 123/2012, 147/13, 163/13, 156/15 dhe 63/16)- Strategjia, planet dhe programet për menaxhim me mbeturina, në detaje e përshkruajn procesin e planifikimit si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel lokal dhe i definojnë kërkesat për dokumentet e planprogrameve.

Dokumentet themelore për planifikim dhe zhvillim për menaxhimin me mbeturina janë:

1.Strategjia nacionale për menaxhim me mbeturina ( e miraton Qeveria për periudhë prej 12 vite me propozim të MMPH)-(neni 16):

2.Plan nacional për menaxhim me mbeturina ( e miraton MMPH për periudhë 10 vjeçare)-  
( neni 17):

3.Programi nacional për menaxhim me mbeturina ( miratohet për periudhë një vjeçare)-  
(neni 19):

4.Planprogramet për menaxhim me mbeturina të NJVL-( neni 18 dhe 19).

Planet me menaxhim me mbeturina të Njësive të Vetqeverisjeve Lokale duhet të jenë në pajtim me strategjinë nacionale për menaxhim me mbeturinat (G.zyrtare 39/08) dhe planin nacional për menaxhim me mbeturina të Republikës së Maqedonisë së Veriut (G.zyrtare 77/09) dhe miratohen në periudhë jo më të shkurtë se tre vjete dhe jo më gjatë se gjashtë vjet. Gjatë përgaditjes së planeve për menaxhim me mbeturina në nivel lokal, poashtu duhet të merren parasysh drejtimet e dhëna në dokumentet planore dhe strategjike,të miratuara në nivel nacional dhe lokal, veçanërisht Plani Aksional Nacional për mjedisin jetësor (PANMJ) dhe Planet Akcionale Lokale për mjedisin jetësor (PALMJ).

Programi për menaxhim me mbeturina, i cili është mjet për realizimin e Planit për Menaxhim me Mbeturina, në nivel vjetor, paraqet dokument themelor për planifikimin e të gjitha aktiviteteve gjatë planifikimit kalendarik, si dhe bazë për llogarinë e pjesës së buxhetit të komunës, e dedikuar për qëllimet të dhëna në Planin dhe Programin për menaxhim me mbeturina.

Ky dokument duhet t'i përcaktojë qëllimet strategjike zhvillimore të Komunës së Tearcës në gjashtë vitet e ardhëshme të dimensionuara në prioritete, realisht të realizuara në kohë të caktuara dhe me kotsruksion financiar të realtë dhe të propozojë Programë për realizim të aktiviteteve për vitin 2020.

Në pajtim me nenin 18 dhe në pajtim me nenin 19 paragrafi 1 pika 2 nga Ligji për menaxhim me mbeturina, kryetari i komunës ia propozon për miratim Këshillit të Komunës, Planin (2020-2025) dhe Programën për menaxhim me mbeturina (2020) .

## I PLANI PËR MENAXHIM ME MBETURINA NË KOMUNËN E TEARCËS (2020-2025)

- Përshkrimi dhe vlerësimi i gjendjes faktike në lidhje me menaxhim me mbeturina.

Komuna e Tearcës gjendet në pjesën veri-perëndimore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, r rëzë Malit Sharr, duke përfshirë një pjesë bukur të madhe të Fushës së Pollogut. Në perëndim komuna kufizohet me Republikën e Kosovës, në jug me Komunën e Tetovës, kurse në verilindje me Komunën e Jegunovcit. Përfshin një hapsirë prej 138,12 km<sup>2</sup> me çka numërohet ndër komunat më të vogla në Republikën e Maqedonisë. Deri më vitin 1965 në përbërje të komunës së Tearcës ishte edhe komuna e tanishme e Jegunovcit ( me Vratnicën). Me organizimin territorial të komunave nga viti 1966, Komuna e Tearcës i është bashkangjitur Komunës së Tetovës. Me ligjin e ri nga viti 1996, Komuna e Tearcës formohet në kufirin e sotëm dhe ashtu edhe sot funksionon.



Në përbërje të komunës së Tearcës marrin pjesë këto trimbëdhjetë vendbanime: Nepreshteni, Leshka, Varvara, Sllatina, Brezna, Tearca, Përshefca ,Glllogja, Jeloshniku, Dobroshti, Nerashti, Odri dhe Përca. Fshatrat Varvara, Brezna, Jeloshniku dhe Përca janë fshatra kodrinoro-malore, kurse të tjerët në pjesën luginore të komunës.

Selia e komunës është në fshatin Tearcë, e cila paraqet qendër administrative, kulturore dhe ekonomike të kësaj pjese në Pollogun e Poshtëm. Komuna shtrihet në një sipërfaqe prej 138,km<sup>2</sup> me 22.454 banorë nga nacionalitetet e ndryshëm ( Shqiptarë, Maqedonë, Turqë, Sërbë dhe Romë). Selia e Komunës së Tearcës gjendet 11 kilometra në veri të Tetovës dhe 50 km në perëndim të Shkupit, në veri të ekuatorit është në 42°04'06"90" kurse në lindje të Griniçit në 21°03'03"07", në lartësi mbidetare prej 490 metra.Sipas regjistrimit nga viti 2002 komuna ka 5.095 amvisëri, gjegjësisht 5.480 banesa. Mesatarisht, çdo amvisëri përbëhet prej 4,41 person.

Tabela 1. Numri i banorëve në komunën e Tearcës

Vendbanimi	Nr.i banorëve
Nepreshten	1309
Leshkë	440
Sllatinë	4112
Tearcë	3974
Përshefcë	2516
Glllogjë	1295
Dobrosht	3549
Odër	1739
Nerasht	3485
Varvarë	0
Brezën	27
Jeloshnik	0
Përcë	8
<b>GJITHËSEJT</b>	<b>22454</b>

Në pajtim me nenin 46 nga Ligji për mbeturina ( Gazeta Zyrtare nr.68/2004,71/2004,107/2007, 102/2008,143/2008, 147/13, 163/13, 156/15 dhe 63/16) menaxhimi me mbeturinat komunale në komunën e Tearcës i është dhënë kompanisë private “Eko-flor Plus”, në formë të koncesionit.

Në komunën e Tearcës momentalisht vetëm 52 % të amvisërive e shfrytëzojnë shërbimin për menaxhim me mbeturina. Numri i shfrytëzuesve të shërbimit çdo vitë rritet, por në përqindje të vogël.

Tabela 2. Shfrytëzuesit e shërbimeve për mbeturina

Viti	2015	2016	2017	2018
Amvisëri	2100	2350	2450	2650
Mbeturinat e transportuara	2511	2810	2930	3169

Sasia vjetore e mbeturinave të ngurta komunale të cilat mblidhen,transportohen dhe deponohen nga ana e Eko-Flor arrin në 3169t/v.

Komuna e Tearcës nuk disponon me deponi për mbeturina. Mbeturina e grumbulluara transportohet nga ana e Eko-Flor në deponinë e Rusinos në Gostivar.

Grumbullimi i mbeturinave komunale kryhet në enë të specializuara edhe atë në kanta nga 120 litra. Kantat për mbeturina i shfrytëzojnë vetëm shfrytëzuesit e shërbimeve të cilët kanë lidhur marrëveshje me koncesionerin. Sasia tjetër e mbeturinave e cila gjenerohet nga amvisëritë të cilët nuk janë shfrytëzues të shërbimeve deponohet në mënyrë të pa kontrolluar në deponitë e egra.

Çmimi i shërbimit është 195 denarë në muaj për një familje. Shprazja e kantave bëhet një herë në javë.

Shprazja e mbeturinave kryhet vazhdimisht, në mënyrë sistematike dhe pa probleme.

Vonesa të rastit mund të ndodhë vetëm në rast të motit të keq.

Sasia totale e mbeturinave të ngurta komunale të gjeneruara në komunën e Tearcës arrinë 6046t/vit. respektivisht 271kg/banorë.

Tabela 3. Mbeturina e gjeneruar në Komunën e Tearcës

Viti	2015	2016	2017	2018
Mbeturina e gjeneruar t/v	6010	6027	6053	6064

Gjithashtu në nivel të Komunës së Tearcës krijohet rreth 2000t/vit. nga rrënojat e ndërtimit, por komuna nuk ka caktuar lokacionin për deponimin e mbeturinave të ndërtimit.

#### 1.1 Gjendjet me selektimin dhe riciklimin e mbeturinave komunale.

Metoda ekzistuese të grumbullimit dhe trajtimit të mbeturinave të ngurta komunale përfshinë klasifikimin dhe riciklimin e këtyre fraksioneve të mbeturinave të ngurta komunale që mund të riciklohen.

Nuk ka organizim primar të selekcionimit të mbeturinave, kështu që si një konglomerat i fraksioneve të ndryshme, mbeturinat komunale mbarojnë në deponi. Struktura e mbeturinave, ose fraksionet nga të cilat përbëhen mbeturina në Komunën e Tearcës nuk është e analizuar.

Në bazë të definimit të më hershëm të sasisë së mbeturinave komunale të cilat gjenerohen në territorin e Komunës së Tearcës në nivel vjetor, si dhe në bazë të strukturës së fraksionit nga mbeturina e identifikuar me Planin Nacional për Menaxhimin me Mbeturina të Ngurta- studime speciale për përbërjen e mbeturinave (Projekt i financuar nga BE nëpërmjet CARDS Programa 2001), në nivel vjetor parashihet se gjenerohen këto lloje të fraksioneve dhe sasi të mbeturinave :



Tabela 4. Përbërja e mbeturinave

Nr.rend.	Shifra e mbeturinave	Lloji i mbeturinave	Përfaqësimi (%)	Saija vjetore
				t/v
1/1	200108	Mb.e biodegradueshme	20,5	1243
2/1	200201	Mb.e biodegradueshme	11,5	697
3/1	200138	Drunjë	1	61
4/1	200101	Letra dhe kartela	10,5	637
5/1	200139	Pllastikë	10	606
6/1	200102	Qelq	3	182
7/1	200111	Tekstil	2	121
8/1	200140	Metale	2,8	170
9/1	150106	Paketim i përzier	3	182
10/1	2001	Mbet. E rezikshme nga amv.	0,2	12
11/1		Mbet. Inerte dhe mbt. Tjetër	8,5	516
12/1	2001	Elemente të imët	27	1637
13/1	2002			
14/1	2003			
GJITHËSEJT			100	6046

Edhe pse në nivel shtetëror ka zinxhir të ndërmarrjeve të cilat merren me grumbullimin e llojeve të mbeturinave ose frakcionet të cilat mund të riciklohen, në Komunën e Tearcës akoma nuk ka ndonjë kompani e cila merret me këtë veprimtari, përveç një kompanie e cila grumbullon hekur të vjetër. Materialet të cilat mund të përdoren ose të përpunohen, kryesisht mbledhen nga sektori joformal dhe më pas shiten për bizneset që kanë të bëjnë me blerjen, shitjen ose përpunimin e lëndëve sekondare.

## 1.2 Gjendjet e mbeturinave biodegraduese

Praktika e mbledhjes së mbeturinave biodegraduese në komunë nuk është e vendosur, në bazë të përdorimit tradicional të së njëjtës në bujqësi të vogla janë gjasa që në të ardhmen ky lloj i mbeturinave të jetë pjesë e një sistemi të organizuar për trajtim. Duke pasur parasysh faktin se mbeturinat e biodegraduara organike, si frakcion në mbeturinat komunale përbëjnë 32%, sasitë vlerësuara të krijuara në Komunën e Tearcës janë dhënë në tabelën e mëposhtme.

Tabela 5. Gjenerimi i mbeturinave të biodegraduara

Viti	2015	2016	2017	2018
Mbeturinat e gjeneruar t/v	6010	6027	6053	6064
Mbeturinat e biodegraduara (32%)	1923	1930	1937	1940

Krijimi i mbeturinave të biodegraduara si pjesë të mbeturinave komunale nuk është e madhe dhe nuk jep indikacione për ndërtim të kompostit lokal vetëm për qëllim të komunës së Tearcës, por nuk duhet të neglizhohet sasia e mbeturinave të biodegraduara që rrjedhin nga bujqësia.

### 1.3 Gjendja me mbeturinat industriale

Në Komunën e Tearcës nuk ka kapacitete industriale të cilët krijojnë mbeturina, por ka ndërmarrje të vogla të cilët merren me prodhimtari dhe ata e shfrytëzojnë shërbimin nga Eko-Flori.

### 1.4 Gjendja me mbeturinat e rrezikshme

Mbeturinat e rrezikshme, të përcaktuara në nenin 6 të Ligjit për Mbeturina (Gazeta Zyrtare nr. 68/2004, 71/2004, 107/2007, 102/2008, 143/2008, 147/13, 163/13, 156/15 dhe 63/16), nuk mund të mbarojnë në asnjë vend të parregulluar dhe nuk mund të deponohen në deponi për mbeturina jo të rrezikshme. Në gjithë territorin e Republikës akoma nuk është rregulluar qasje ndaj menaxhimit me mbeturina të rrezikshme dhe nuk ka deponi të caktuar në të cilën e njëjta do të deponohet. Rasti i njëjtë është edhe me komunën e Tearcës, ku nuk merret parasysh ndarjen e mbeturinave të rrezikshme (bateri, derivate, yndyrat, akumulator, etj.), mbledhja e duhur dhe trajtimi. Rezultati i saj është deponimi i tyre në deponi. Shumë lloje të ndryshme të mbeturinave të rrezikshme, të cilat mund të identifikohen në bazë të Listës së mbeturinave (Gazeta Zyrtare e RM br.100/05) deponohen në deponit për mbeturina komunale. Përafërsisht 0.2% e mbeturinave të përgjithshëm mund të klasifikohen si mbeturina të rrezikshme. Këtu nuk janë përfshirë mbeturinat e rrezikshme që vjen nga institucionet e medicinës, të konsideruara si mbeturina medicinale, si një fraksion i veçantë, i cili është një problem serioz dhe një kërcënim për kualitetin e mjedisit jetësor.

1.5 Gjendja me situatat finaciare gjatë menaxhimit me mbeturinat në komunë.

Menaxhimi me mbeturinat komunale në komunën e Tearcës i është dhënë kompanisë private “ Eko-Flor Plus”.

2.Parashikimi i gjendjes në të ardhmen në lidhje me menaxhimin me mbeturina.

2.1 Gjenerimi i mbeturinave.

Duke pas parasysh se numri i banorëve në vitet e fundit tregon një rritje prej 1promil në komunën e Tearcës, duke i përfshirë edhe indikatorët për natalitet, mortalitetin dhe rritja natyrore të banorëve, parashihet se ky trend do të ngel edhe për 6 vite të ardhshme. Në qoftë se parashihet poashtu se krijimi i mbeturinave për banorë në nivel vjetor nuk do tejkalon 271 kg, për shkak të rritjes së ngadalshme të ekonomisë dhe standardit jetësor të banorëve të komunës, atëherë trendi i prodhimit të mbeturinave për 6 vitet e ardhshëm do mund të jetë:

Tabela 6. Gjenerimi i mbeturinave në vitet 2020-2025 në Komunën e Tearcës

Viti	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Numri i banorëve	23023	23046	23069	23092	23115	23138
Gjenerimi i mbt. t/v	6239	6245	6251	6257	6264	6270

2.2 Grumbullimi, transportimi dhe deponimi i mbeturinave

Sistemi i grumbullimit, transportit dhe deponimit të mbeturinave deri më tash kryhet nga “ Eko-Flor”. I njëjti është parashikuar të menaxhon në territorin e Komunës së Tearcës deri më 2021 sipas kontratës për koncesion ose deri në momentin kur do të zbatohet menaxhimi regjional me mbeturina e cila është në fazë fillestare për regjionin e Pollogut. Vendi ku do të deponohet mbeturina është deponia “Rusino” në Gostivar, e cila edhe deri më tash është shfrytëzuar për deponimin e mbeturinave komunale.

3. Drejtimet dhe qëllimet në lidhje me menaxhimin me mbeturina.

Komuna e Tearcës ka për qëllim të harmonizojë menaxhimin me mbeturina të parashikuara në kornizat duhura ligjore dhe dokumentet ligjore.Ligji për Menaxhimin e mbeturinave është hartuar në bazë të konceptit fundamental apo hierarkisë së menaxhimit të mbeturinave ku

opsionet e ndryshme për trajtimin e mbeturinave i kategorizon nga më e mirë deri te më e keqja, sipas renditjes në vijim:

1. Preventiva: (reduktimi / minimizimi i krijimit të mbeturinave)
2. Ripordorimi
3. Riciklimi/kompostimi
4. Shfrytëzimi i energjisë që e posedojnë mbeturinat nëpërmjet të djegies
5. Mënjanimi (i deponimit)

Komuna, do të respekton drejtimit e dhëna në legjislativën e përkthyer dhe nëpërmjet përmbushjes së aktiviteteve të dhëna në Planin dhe Programin për menaxhim me mbeturina , do ta përmirëson gjendjen me menaxhimin me mbeturina në Komunë.

4. Masat stimulative për zbatimin e aktiviteteve për të shmangur dhe për të zvogëluar sasinë e mbeturinave që krijohen si dhe ripërdorimin, riciklimin dhe përdorimin i mbeturinave si burim energjie.

Objektivi kryesor në çdo menaxhim me mbeturina është për të minimizuar sasinë e mbeturinave që do të depozitohen dhe të përdoret çdo pjesë të mbeturinave që ka vlerën e duhur në përdorim. Shumë nga masat që mund të aplikohen në mënyrë për të reduktuar sasinë e mbeturinave të krijuara si dhe dhe ripërdorimin, riciklimin dhe përdorimin e mbeturinave si burim i energjisë, janë duke u zbatuar ose do të zbatohen në nivel kombëtar. Nëse ka hapsirë të përshtatshme, vend për grumbullimin e mbeturinave që mund të riciklohen (letër, plastikë, metale, mbeturina organike, etj), e të cilët do të vendoseshin nga sektori privat ose përmes programeve të koncesionerit për të futur mbledhjen selektive të mbeturinave komunale, sasia e mbeturinave të deponuara bindshëm do të zvogëlohet.

Në drejtim të forcimit të vetëdijes dhe motivimit e popullatës për nevojën për të reduktuar dhe selektuar mbeturinat, është e rekomandueshme të aplikohen masa stimulative, të shprehura me:

- Uljen e kostos së mbledhjes së mbeturinave, për ata që do të kryejnë selektimin e mbeturinave. Vlerat, dmth sasat e cila do të përfundon në deponi do të reduktohet në mënyrë të konsiderueshme, duke përmirësuar cilësinë e mjedisit jetësor. Fizibiliteti i këtij

kriteriumi mund të vlerësohet në bazë të analizave të shpenzimeve për transport të mbeturinave pa zbatim të mëparshëm të selekcionimit dhe me zbatim të sistemit të selekcionimit të mbeturinave.

-dhënia e lejeve për parandalim të integruar dhe kontrollin e ndotjes.

Instalimet, si masa për të zvogluar dhe shamngur gjenerimin e mbeturinave nga kapacitetet industriale, duhet ti zbatojnë rekomandimet nga teknologjitë më të mira të disponueshme që është bazë për lëshimin e lejeve ekologjike integruese për të cilët është kompetente Komuna. Në rast më të mirë kushtet tregtare duhet të ndikojnë në mënyrë stimulative ndaj sektorit të biznesit në këtë lëmi.

5.Mënyrat për mënjanimin e mbeturinave që nuk mund të shmangen dhe të përpunohen.

Gjatë menaxhimit të duhur që është fillimi me sistemin e separimit të mbeturinave, do të kontribuoj në zvogëlimin e sasive të mbeturinave që deponohen në deponi.

Përveç fraksioneve që kanë vlerë ekonomike dhe mund të përdoret në mënyra të ndryshme, mbetjet e tjera duhet të hudhen në deponi.

Duke pasur parasysh gjendjen aktuale me menaxhim me mbeturina,në mungesë të ndarjes të së njëjtës, dhe raste të vogla të ripërdorimit dhe riciklimin, duke i shtuar asaj edhe gjendjen aktuale të deponisë në "Rusino", e cila nuk i plotëson as kriteret minimale teknike, duhet të vendosen theks të veçantë hedhje së mbeturinave. Tash është në rrjedhë procedura për menaxhim regjional me mbeturinat në regjionin e Pollogut, ku edhe Komuna e Tearcës , bashkë me komunat fqinje kanë të formuar trup të përbashkët për menaxhim . Ky rekomandim është një nga masat e parashtruara në strategjinë për menaxhim me mbeturina. Me ndërtimin e deponisë së përshtatshme sanitare regjionale, atëherë mbeturinat të cila nuk do mund të përpunohen, selekcionohnt, ripërdoren ose riciklohen, do të depozitohen në deponinë sanitare dhe nuk do të paraqes rrezik për mjedisin jetësor. Mënyra e këtillë e menaxhimit me mbeturina jo që do ta zgjedh problemin e krijmitë mbeturinave të tepërta,por do të kontribuon në mënyrë të drejtë për mirëmbajtjen e së njëjtës, me çka do të zvogëlohet ndotja e mjedisit jetësorë.

6. Përcaktimi i llojit dhe sasisë së mbeturinës sipas së cilës përcaktohet obligimi i personave juridikë dhe fizikë të përgaditin programe për menaxhim me mbeturina.

Përshkak të zbatimit të sistemit për menaxhim me mbeturina në nivel komunal, duhet të jenë të kyqur të gjithë prodhuesit e mbeturinave ( personat Individual, fizikë dhe juridikë) dhe të arrihet bazë e duhur e të dhënave për të gjithë personat juridik dhe fizik të cilët menaxhojnë në komunën e Tearcës. Pas identifikimit, duhet të shqyrtohen ato kapacitete industriale të cilët sipas ligjit për mjedisin jetësor (Gzt.Zyrtare e RM.nr.53/05,81/05,24/07,159/08.83/09, 48/10,124/10,51/11, 123/12, 93/13 dhe 44/15) dhe Ligjit për mbeturina (Gz.Zyrtare e RM nr.68/2004,71/2004,107/2007,102/2008,143/2008, 123/2012, 147/13, 163/13, 156/15 dhe 63/16 ) janë të obliguar të përgatitin programë për mjedisin jetësor,d.m.th instalimet të cilët janë përfishrë në MKIN (Mbrojtja dhe Kontrollimi Integrues i Ndotjes) mënyra dhe neni 21 nga Ligji për mbeturina, i cili thotë se të gjithë krijuesit e mbeturinave me sasi vjetore më të mëdhaja se prej 150 t mbeturinë jo e rrezikshme ose 200 kg mbeturinë të rrezikshme, janë të detyruar të përgaditin dokumente planore për menaxhim me mbeturina. Subjektet e tilla duhet që dokumentet planifikuese për mbeturinë jo të rrezikshme t`i dorëzojnë në komunë për shqyrtimin dhe miratimin e tyre , kurse dokument planifikuese për mbeturina të rrezikshëm duhet t`i dorëzojnë deri te organi përgjegjës për mjedis jetësor ( Ministria për Mjedis Jetësor dhe Planifikim Hapësinor) prë shqyrtim dhe miratim.

7.Realizimi i sistemit për monitorim gjatë menaxhimit me mbeturina

Sipas Ligjit për Mbeturina dhe Kapitullin X, Monitorimi, komuna duhet të monitorojë menaxhimin e mbeturinave përmes zbatimit të aktiviteteve të definuara në planin për menaxhimin të mbeturinave të Komunës së Tearcës.

Monitorimi i menaxhimit me mbeturina përbëhet nga:

- 1) monitorimi i situatës me mbeturina;
- 2) grumbullimi dhe dorëzimi i të dhënave për llojin, sasinë dhe origjinën e gjenerimit, përpunimit dhe asgjësimit të mbeturinave;
- 3) marrjen e mostrave dhe naliza e tyre;
- 4) të dhënat për eksportimin, importimin dhe tranzitimin e mbeturinave;
- 5) kontrollimi,përpunimi dhe analiza e të dhënave;
- 6) njoftimi dhe paralajmërimi i organeve përgjegjëse për rrezikun e mundshëm;
- 7) sigurimi i informacioneve për ndikimin e mbeturinave të krijuara ndaj mjedisit jetësor;

8) bashkëpunimi dhe shkëmbimi i të dhënave me rrjetet informative ndërkombtare;

Pranimi i të dhënave për monitorimin e zbatimit të planit dhe programit në përgjithësi duhet të sigurohet nga mbushja e formularëve për identifikimin dhe transportin e mbeturinave dhe duke plotësuar raporte vjetore mbi menaxhimin e mbeturinave.

Të gjitha këto dokumente janë pjesë e aktit nënligjor: "Rregullore për formën dhe përmbajtjen e të dhënave në ditarin për trajtimin dhe evidentimin e mbeturinave, formën dhe përmbajtja e formularëve të transportit dhe identifikimin e mbeturinave dhe forma e përmbajtjes së raporteve vjetore për menaxhimin e mbeturinave (Gz. Zyrtare nr.7/2006) dhe paraqesin një obligim për kompanitë që menaxhojnë me mbeturinat, si dhe për autoritetet komunale. Administrata lokale nëpërmjet këtyre instrumenteve në çdo kohë mund të ketë një pasqyrë të situatës në fushën e menaxhimit të mbeturinave. Kuptohet që kjo praktikë nuk ekziston ende, por në të ardhmen do të zbatohet sistemi për të monitoruar situatën me mbeturina në Komunë.

Kryetari i komunës është i obliguar të dorëzoj raport vjetor për mbeturinat e parrezikshme në komunë, deri te Ministria përkatëse, më vonë deri në muajin mars për vitin e kaluar.

8. Masat konkrete dhe aktivitetet për zvogëlimin e përbërjeve biodegraduese në mbeturinë e dedikuara për mënjanim dhe programet kohore dhe vëllimi i realizimit të tyre.

Të gjitha aktivitetet , të cilët çojnë kah zvogëlimi i përbërjeve të biodegraduara në mbeturinat të cilat transportohen në deponi, janë të përfshira në zbatimin e parashikuar të seleksionimit të mbeturinave të biodegraduara dhe kompostimi i saj. Duke pasur parasysh faktin se në Komunën e Tearcës sasia e krijuar e mbeturinave biodegraduese nga amvisëritë është relativisht e vogël, jo më tepër se 1940t/vit, problem me ndarjen e këtij llojit të mbeturinave do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

## 8.1 Baza për zbatimin e kompostimit të mbeturinave të biodegraduara.

Direktiva Europiane për deponim udhëzon nevojën që shtetet të zvogëlojnë sasinë e deponimit të mbeturinave organike. Për këtë arsye mbeturina organike në të ardhmen do të duhet të destinohet dhe të trajtohet jashtë deponive. Në qoftë se për mbeturinat mendohet në mënyrë ekonomike dhe të qëndrueshme, është e mundur një pjesë nga frakcioni organik të mbeturinës së ngurtë komunale të shfrytëzohet dhe të prodhohet kualitet të lartë të përmirësuar (bonifikator) të dheut, kompostit, me kosto të krahasueshme ose pak më të lartë se ajo për deponim, kurse më e ulët nga ajo për djegie, e cila do të ishte opcioni i dytë për ridestininim të mbeturinës organike jashtë deponive. Pra, komposti i prodhuar do të ketë efekte indirekte në sasinë dhe cilësinë e prodhimit bujqësor me qëllim rritjen e cilësisë së tokës. Gjatë vlerësimit të të mirave të kompostimit duhet të merr parasysh efektet ekonomike të reduktimit të hapësirës së grumbullimit dhe vazhdimi i jetës së përdorimit të deponisë.

Opsionet për kompostim në komunën e Tearcës janë të kufizuara për shkak të sasive të limituara të frakcioneve organike në mbeturinat komunale e cila çon në opsione nga kompostimi individual ose shoqërim regjional të më shumë komunave me kompostarë qendror e cila do të mundësonte kompostim efektiv, me çmime të ulëta të trajtimit dhe kualitet të lartë të kompostit.

## 9. Përcaktimi i nevojave të komunës për ndërtimin e objekteve dhe instalimeve për përpunimin e mbeturinave

### 9.1 Drejtimet gjenerale për planifikimin e periudhës së ardhshme në relacion të menaxhimit me mbeturina.

Përcaktimi i mënyrës më të përshtatshme të menaxhimit të mbeturinave për Komunën e Tearcës kryesisht duhet të varet nga mundësitë aktuale për zbatimin e kësaj detyre. Konsiderohet se sipas të gjitha kushteve (institucionale, organizative, financiare, teknike dhe të burimeve njerëzore), komuna ka aftësi shumë të kufizuara. Në përgjithësi, koncepti i periudhës së planifikimit duhet të drejtohet në dy drejtime:

1. Vendosja e një sistemi të ri të menaxhimit të mbeturinave përmes një qasje rajonale;
2. Sjellja e një sistemi për selektimin primar të mbeturinave.



Direktivat e BE-së që janë në legjislacionin kombëtar, janë udhërefyesh për krijimin e mënyrës më të përshtatshme të menaxhimit të mbeturinave. Ata kërkojnë menaxhimin e përgjithshëm të mbeturinave të jetë i sigurtë për shëndetin e njeriut dhe mjedisin. Bazuar në drejtimet e përgjithshme të lartpërmendura për të arritur nivelin minimal të pajtueshmërisë me këto udhëzime është e nevojshme për të kryer aktivitetet e mëposhtme për një periudhë prej gjashtë vitësh:

- Zbatimi gradual i një praktike të re për deponimin e mbeturinave në deponi;
- Llogaritja e gjithë harxhimeve të krijuara gjatë menaxhimit të mbeturinave për formimin e çmimit të shërbimit;
- Sistemi rajonal për menaxhimin e mbeturinave;
- Zbatimi gradual i selekcionimit të mbeturinave komunale në pikën e krijimit (amvisëritë, të industrisë dhe institucioneve);
- Zhvillimi i kampanjave publike mbi nevojën dhe përfitimet e ndarjes së mbeturinave dhe kompostimit.

## 9.2 Bazat e zbatimit të selekcionimit primar të mbeturinave

Baza strategjike në lidhje me selekcionimin e mbeturinave në nivel shtetëror është reduktimi i tij, ripërdorimi dhe riciklimi, për shkak të qëndrueshmërisë ekonomike dhe ruajtjen e mjedisit jetësor.

Pjesëmarrja proporcionale e secilit frakcion në mbeturina komunale është marrë nga Plani Kombëtar për menaxhimin me mbeturina të ngurta - Studimin - special për përbërjen e mbeturinave, ku janë bërë matjet e fraksioneve të mbeturinave komunale në zonat urbane, gjysmëurbane dhe mjediset rurale.

Riciklimi dhe ripërdorimi i fraksioneve të vlefshme nga mbeturinat është një nga elementet themelor të menaxhimit modern të qëndrueshëm të mbeturinave. Vlera e këtyre materialeve, sidomos materialet që prodhohen nga lëndët djegëse, fosile (plastike), dita ditës është në rritje dhe me të përpunimi i tyre bëhet më efektive.

Mund të konkludohet se në Komunën e Tearcës, fraksionet nga mbeturina e cila mund të përpunohet janë realtivisht të vogla dhe mënyra për zbatimin e seleksionimit primar do të varet nga pagesa e saj.

#### 10. Lokacionet dhe instalimet për mënjanimin e mbeturinave.

Në Komunën e Tearcës nuk ka deponi sanitare, mbeturinat e mbledhura transportohen nga ana e EKO-FLOR-it në deponinë e "Rusinos", por ende janë aktive deponitë e egra nëpër të gjitha vendbanimet në Komunën e Tearcës dhe sasia e madhe e mbeturinave hudhet në mënyrë jo të kontrolluar në deponitë e egra.

Pritet që të zgjidhet ky problem me mënyrën e hudhjes së pakontrolluar të mbeturinave në deponitë e egra, nga momenti kur do të hyjë në fuqi menaxhimi regjional me mbeturina.

#### 11. Të dhënat për rrjetin e integruar nacional për mënjanimin e mbeturinave dhe instalimet për përpunimin e mbeturinave

Rrjeti i integruar i instalimeve për hedhjen e mbeturinave dhe përpunimin e mbeturinave në nivel të R. Maqedonisë nuk ekziston sepse deponitë janë ende në nivel të ulët në krahasim me standardet e miratuara, që të jenë të ligjshme për të shërbyer për pranimin dhe deponimin e mbeturinave nga komunat tjera, edhe pse në praktikë kjo ndodh, por në një mënyrë të papërshtatshme. Në lidhje me kapacitetet e objekteve për përpunimin e mbeturinave (riciklimi), poashtu nuk janë të rregulluara të dhënat në lloj të rrjetit të integruar nacional. Në pajtim me Strategjin për Menaxhim me Mbeturina dhe draft versionin e planit nacional për menaxhim me mbeturina, nëpërmjet zhvillimit të sistemit regjional për menaxhim me mbeturinat komunale do të mundësohet të krijohet rrjeti i integruar nacional për largimin e mbeturinave.

#### 12. Kushtet teknike të cilët duhet të plotësohen gjatë menaxhimit me mbeturina.

Në rregulloren për veprim me llojet e tjera të mbeturinave komunale dhe jo të rrezikshme (Gazeta zyrtare e RM nr.147/07) qartazi janë të vendosura kushtet që në mënyrë të drejtë të veprohet me menaxhim me mbeturina.

### 13. Masat për sanim të deponive të egra dhe regjioneve të ndotura.

Deponit e egra të indentifikuara në gjithë territorin e komunës, paraqesin kërcënim serioz për prishjen e medimeve të mjedisit jetësor. Deponitë e egra janë si rezultat i hudhjes në mënyrë të pakontrolluar të mbeturinave komunale, të rrezikshme dhe të mbeturinave inerte, por përsëri komuna duhet të gjejë mënyra se si ta ngren vetëdijen e banorëve rreth mënyrës së selektimit, riciklimit dhe hudhjen e mbeturinave. Edukimi i banorëve është një ndër masat prioritare të cilat, duhet të zbatohen me qëllim që të zvogëlohet numri i deponive të egra.

Tabela 7. Deponitë e egra në Komunën e Tearcës

Vendbanimi	Nr.i deponive	Sipëfaqe(m <sup>2</sup> )	Vëllimi (m <sup>3</sup> )
Nepreshton	2	20000	10000
Leshkë	2	2000	2000
Sllatinë	1	37500	56250
Tearcë	2	2000	2000
Përshevcë	1	40000	60000
Glllogjë	1	10000	30000
Dobrosht	2	6000	9000
Odër	1	1000	1000
Nerasht	1	4500	2250
GJITHËSEJ	13	123000	172500

Deponit e egra në ardhmëri do të jenë të përfshira me plane urbanistike, gjatë së cilës do tu jepen destinime në të ardhme. Mbeturina e cila gjendet tek ata duhet të dislokohet dhe varësisht nga kategoria e saj do hudhet në deponi të duhur. Hapësira e cila më herët ka qenë deponi e egër, deri te përdorimi i fundit (e shënuar në planet urbanistike të ardhshme), komuna do ta rikultivon.

### 14. Aktivitetet të cilat, ndërmerren nga ana e njësisë së vetqeverisjes lokale në lidhje me menaxhimin me mbeturina.

Në bazë të vlerësimeve dhe konstatimeve të mëparshme, janë definuar akcionet të cilat duhet të plotësohen në periudhën e ardhshme gjashtëvjeçare, të paraqitura në tabelën nr. 8. Akcionet e propozuara janë dhënë duke i marrë parasysh mundësitë reale të Komunës së Tearcës, si dhe kërkesat të cilat dalin nga ligji nacional kornizë dhe direktivat e BE-së.

Plotësimi ose mos plotësimi i aksioneve në masë të madhe do të varet nga efikasiteti i vet komunës, gradualisht, në faza të planifikojë, të implementojë dhe krejtësisht të merret me këtë problematikë.

Përqindja e propozuar e popullsisë shërbyese, niveli i selektimit dhe niveli riciklimit të kompostimit janë dhënë në bazë të supozimeve për hyrjen e kapitalit privat në këtë sektor, si opsion më i mundshëm për të arritur objektivat e dhëna. Në çdo rast, realizimi i planit duhet të monitorohet në mënyrë sistematike dhe gjithmonë të intervenohet nëse është e nevojshme.

Tabela 8. Aktivitetet e parapara në planin për menaxhim me mbeturina 2020-2025

Aksionet	2020	2021	2022	2023	2024	2025	Resuraset finansiare
Përforcimi i resurseve administrative	Formimi i departamentit për mjedisin jetësor	Punësimi ose autorizimi i një këshilltari për mbeturina	Formimi i departamentit për PIKN	Formimi i departamentit për mbeturina			Buxheti i komunës
Regullimi i deponive të egra	5000 m <sup>2</sup>	1000 m <sup>2</sup>	20000 m <sup>2</sup>	25000 m <sup>2</sup>	30000 m <sup>2</sup>	33000 m <sup>2</sup>	Buxheti i komunës, Programet finansiare, Donatorë
Menaxhimi regjional me mbeturina-regjioni i Pollogut	Fillimi i sistemit të ri regjional për menaxhim me mbeturina	Mbulimi i 80% të banorëve jo shëbyes	Mbulimi i 90% të banorëve jo shëbyes	Mbulimi i 95% të banorëve jo shëbyes			NPP
Zbatimi i sistemit për selektim dhe grumbullim të mbeturinave	Punët e përgatitura për trajtim	Mbulimi i 30% të banorëve	Mbulimi i 40% të banorëve	Mbulimi i 60% të banorëve	Mbulimi i 80% të banorëve	Mbulimi i 95% të banorëve	Marëveshje me operator privat
Ngritja e vetëdijes publike	Përgaditja e programës për ngritjen e vetëdijes publike	Kampanjë për menaxhim të drejtë me mbeturina	Kampanjë për menaxhim të drejtë me mbeturina	Realizimi i aktiviteteve nga programa	Realizimi i aktiviteteve nga programa	Realizimi i aktiviteteve nga programa	Buxheti i komunës, donacione

## 15. Masa për edukimin dhe ngritjen e vetëdijes për menaxhim me mbeturina

Vendosja e praksës për përfshirjen e publikut është një faktor i rëndësishëm në marrjen e vendimeve , të rëndësishme për mjedisin jetësor , nëpërmjet bashkëpunimit me shërbimet publike , pushtetin lokal dhe OJQ-të . Procedura për përfshirjen e publikut është përcaktuar në Konventën e Aarhusit dhe u bë një detyrim për R. Maqedonisë në ditën e ratifikimit të saj . Gjithashtu , elementet e Konventës janë pasqyruar në ligjin për mjedisin jetësor , të cilat garantojnë të drejtën e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje dhe qasje në drejtësi për pyetje në lidhje me mjedisin jetësor. Aktiviteti kryesor në gjithë procesin është organizimi për mbledhjen e mbeturinave , si vendim të qytetarëve . Publiku do të jetë i qartë dhe i informuar saktë për mënyrë mbledhjes .

Publiku duhet të informohet dhe të arsimohet në lidhje me nevojën për zvogëlimin e mbeturinave dhe ripërdorimin dhe riciklimin e tij . Për çdo aktivitet që do të merrkomuna , publiku do të informohet dhe do të jetë e përfshirë në të.

Në procesin e përcaktimit të çmimeve për shërbimet në mjedisin jetësor , publiku duhet të përfshihet , dhe koordinator i veprimtarisë mund të jetë një OJQ lokale e cila , është e angazhuar në këtë aktivitet apo profesionistë të tjerë që merren me këtë çështje . Në këtë mënyrë popullsia më e lehtë do të pranojë përgjegjësinë dhe me ndërgjegje do ta realizojë .

Media është një mjet i omunës për të informuar më mirë publikun për çdo veprim të ndërmarrë nga ata që menaxhojnë mbeturinat .

Aktivitetet që do të ndërmerren për të realizuar " Fushatën për të rritur ndërgjegjësimin e publikut " :

- Dorëzimi i fletushkave reklamuese të shërbimeve komunale .

- Vendosja e posterave në vende në dispozicion në komunë me qëllim të promovimit projektit dhe informimi i publikut për rëndësinë e menaxhimit të mbeturinave dhe zhvillimin e qëndrueshëm të komunës në të ardhmen ;

Mbajtjen e një konference për shtyp me qëllim që të paraqitet projekti , objektivat dhe aktivitetet e saj . Në konferencë duhet të ftohen përfaqësues të mediave elektronike dhe të shkruara ;

- Web prezantimi i aktiviteteve të kryera në këtë fazë .

## 16. Vlerësimi i shpenzimeve për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave.

Me zbatimin e menaxhimit regional me mbeturina në regjionin e Pollogut, përpunimi i mbeturinave do të jetë obligimi i NPP (ndërmarrja e përbashkët publike) ose koncesionerit, por komuna duhet në të ardhmen të merret me largimin e mbeturinave nga deponitë e egra dhe rregullimin e të njëjtave.

Tabela 9. Shpenzimet operative për rregullimin e deponive të egra.

Viti	2020	2021	2022	2023	2024	2025	Gjithësejt
Regullimi i deponive të egra (m <sup>2</sup> )	5000	10000	20000	250000	30000	33000	123.000
Mjetet financiare (den)	1.500.000	3.000.000	6.000.000	7.500.000	9.000.000	9.900.000	36.900.000

## 17. Instrumentet finaciare për zbatimin e planit për menaxhim me mbeturina.

Plani për financimin e aktiviteteve për zbatimin e planit dhe programit në vete përfshinë :

- Mjetet finaciare nga burimet e veta dhe

- Mjetet finaciare nga burime të jashtme .

Për kategorinë e parë të aktiviteteve nga plani dhe programi të cilat nuk mund të marrin karakterin e ashtuquajtur shpenzimet e projektit të financuara nga burime të jashtme , është llogaritur se komuna duhet të angazhojë resurset vetanake intelektuale ose të angazhojë nga mjetet e veta këshilltarë lokalë/regjionalë për realizimin e këtyre aktiviteteve.

Kategoria e dytë e aktiviteteve të planit dhe programit që mund të marrë të ashtuquajturin karakter të shpenzimeve të projektit të financuara nga burime të jashtme , është llogaritur se duhet të përgatitet dhe të kryhet një procedurë tenderi për realizimin e tyre . Shpenzimet për organizimin dhe zhvillimin e tenderit do të paguhen nga burimet vetanake , ndërsa furnizimi do të financohen nga fondet e jashtme .